



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0021467-4/26 dt. 29.04.2026
Mitrovicë

02-060/01-0021467-4
29.04.2026

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 4, paragrafi 1,2,3 dhe nenin 14 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna: nenit 15 paragrafi 1,2,3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komonë: nenin 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për organizmin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane: në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Statutit të Komunës; Kuvendi i komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.04.2026 pasi shqyrtoi Propozim Vendimin Për kompensimin të anëtarëve të Komiteteve Konsultative, Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (konkluzioni Nr. 02-060/01-0018345-4/26 dt. 20.04.2026) sjell këtë:

VENDIM

Për kompensimin të anëtarëve të Komiteteve Konsultative, Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026

1. MIRATOHET vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative dhe Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve Ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës për vitin 2026 në Komonën e Mitrovicës së Jugut, në shumën prej 50,00 € (pesëdhjetë) për mbledhje.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi Anëtarët e komiteteve konsultative të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut me Vendimin Nr. 02-060/01- 0011451-4/26 dt. 27.03.2026, për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës, Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.
 - 2.1 Anëtarët e komiteteve konsultative nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
 - 2.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët Komitetit marrin pjesë në mbledhje.
3. Anëtarët e Komiteteve Tjera që janë themeluara nga Kuvendi i Komunës për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës, Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.
 - 3.1 Anëtarët e komiteteve tjera nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të

cilat mbahen brenda vitit.

- 3.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët Komitetit marrin pjesë në mbledhje.
- 3.3 Anëtarët e komiteteve tjera përfshin anëtarët e komiteteve themeluara me Vendime të kuvendit të komunës si në vijim:
- 3.3.1 Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-6/26, dt. 10.02.2026,
- 3.3.2 Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-7/26, dt. 10.02.2026,
- 3.3.3 Komiteti për Zhvillim Ekonomik Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-8/26, dt. 10.02.2026,
- 3.3.4 Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-9/26, dt. 10.02.2026,
- 3.3.5 Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-10/26, dt. 10.02.2026, dhe
- 3.3.6 Komiteti për Barazi Gjinore Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-11/26, dt. 10.02.2026.
4. Kryetarët e këshillave lokale për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.
- 4.1 Kompensimi për pjesëmarrjen në mbledhje bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit.
- 4.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse kryetari merr pjesë në mbledhje.
5. Anëtarët e Komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, kompensohen nga buxheti i komunës Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës. Anëtarët e komisioneve ad hoc nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
6. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
 Të gjitha drejtorive